



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË

Numri i lëndës: 2022:057897

Datë: 14.05.2024

Numri i dokumentit: 05682538

C.nr.192/2022

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-DEGA NË SUHAREKË, nga Gjyqtari Robert Tunaj, me pjesëmarrjen e praktikantes Saranda Aliaj, në çështjen juridike civile të paditësit SH.K nga S, mësimëdhënëse në SHMP “Vëllezërit Frashëri” në B –K. S, të cilën me autorizim e përfaqëson Av.B. K,nga P, ndaj të paditurës K e S, D. K e A, me objekt kontesti kompensimi i kualifikimit nga marrëdhënia e punës,me dt.14.05.2024, bie këtë:

A K T G J Y K I M **Pa shqyrtim kryesor**

- I. APROVOHET** pjesërisht kërkesëpadia e paditësit: Sh. K,
- II. DETYROHET** e paditura K e S – D. K e A, që paditësit në emër të kompensimit të kualifikimit nga marrëdhënia e punës,t’ia paguaj shumat si në vijim:
Paditësit Sh. K, në emër të kualifikimit nga marrëdhënia e punës për periudhën **28.03.2019 deri me 31.12.2020** ,për 21 muaj shumën e përgjithshme : **1265,25 euro**,me kamatë ligjore prej 8% nga data e parashtrimit të padisë me datë:28.03.2022 gjerë në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.
- III. REFUZOHET** padia dhe kërkesëpadia për kompensimin e kualifikimit nga marrëdhënia e punës për periudhën 18.04.2017-28.03.2019 si e parashkruar.

A r s y e t i m

Paditësi: Sh. K, pranë kësaj Gjykate me datë :18.08.2022, përmes të autorizuarit të tij Av.B. K nga P, ka parashtruar padi kundër të paditurës K e S – D. K e A, për pagesë të kualifikimit nga marrëdhënia e punës sipas Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë dhe Ligji i Punës nr.03/L-212.

E paditura përmes përgjigjes në padi të dt: 01.11.2023 e ka kontestuar bazën e padisë dhe kërkesëpadisë për kompensim të kualifikimit nga marrëdhënia e punës dhe i ka propozuar gjykatës që e njëjta të refuzohet në terësi si e pa bazuar. E nëse mbi këtë bazë nuk e refuon atëherë ta refuzoj për shkak të parashkrimit

Gjykata pas vlerësimit të shkresave të lëndës, konkretisht provave materiale të bashkëngjitur padisë, e në kuptim të nenit 8 të Ligjit për procedurën kontestimore, pas çmuarjes me kujdes dhe me ndërgjegje të secilës prej tyre dhe të gjitha ato së bashku, ka gjetur se:

Kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar.

Në nenin 143 paragrafin 1 të Ligjit të procedurës kontestimore parashihet që: *“Me aktgjykim gjykata vendos mbi kërkesën që ka të bëjë me çështjen kryesore dhe me kërkesat aksesore.”*

Ndërsa në nenin 152 të Ligjit të procedurës kontestimore parashihet që: *“ Po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi, i ka pohuar faktet vendimtare, përkundrejt kontestimit të kërkesëpadisë, gjykata mundet pa caktuar seancë gjyqësore, të jep aktgjykim (neni 143 dhe 147 të këtij ligji), nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënie të tij.”*

E drejta që në këtë çështje juridiko civile vendimmarrja të bëhet pa shqyrtim kryesor, me të vetëm arsye për zbatimin e ekonomizimit të procedurës, parim ky i sanksionuar dhe i urdhëruar për gjykatën për t’u zbatuar konform nenit 10 paragrafit 1 të Ligjit të procedurës kontestimore, siç parasheh: *“Gjykata ka për detyrë të përpiqet që procedura të zhvillohet pa zvarritje dhe me sa më pak shpenzime, si*

dhe të bëjë të pamundur çdo shpërdorim të së drejtave procedurale që u takojnë palëve sipas këtij ligji.”

Në nenin 7 paragrafin 1 të Ligjit të procedurës kontestimore parashihet që: *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla.”*

I autorizuari i paditësit, me rastin e ngritjes së padisë për kompenzim të kualifikimit nga marrëdhënia e punës , i ka bashkëngjitur padisë vërtetimet lidhur me provimin e fakteve për ditët e punës, të cilat paraqiten si bazë për kërkimin e shumave të papaguara.

Nga shikimi në kontratën e punës për mësimëdhënës nr.protokollit:335/2019 e datës 02.09.2019 i lëshuar nga Drejtoria Komunale e Arsimit dhe Shkencës në Suharekë,licensa e ,mësimëdhënësit nr.100012684,diploma e Fakultetit Ekonomik – Universiteti i Prishtinës.

Bazuar në provat e lartcekur, shihet se kërkesa e paditësve gjen mbështetje të plotë në nenin 7 par.1.2 dhe 1.3 të Kontratës Kolektive e 18.04.2017, ndërmjet SBASHKU-ut dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të Republikës së Kosovës, siç parashihet se *“Me licencim fitohet e drejta në punë, avancim, karrierë dhe zhvillim profesional në bazë të legjislacionit të punës në fuqi. Të punësuarve u mundësohet kualifikimi pa shkëputje nga puna sipas legjislacionit në fuqi dhe mbi bazën e kualifikimit dhe të: Mësimdhënës me shkollë normale 10% e pagës bazë, Mësimdhënës me shkollë të lartë pedagogjike dy vjeçare 19% e pagës bazë, Mësimdhënës me diplomë fakulteti tri vjeç dhe katër vjeçar 27% e pagës bazë, Mësimdhënës me diplomë 5 vjeçar, magistraturë/master dhe doktoratë 35% e pagës bazë.”*

Gjykata vendosi që t’ia falte besimin provave që ka prezentuar paditësi konkretisht vërtetimit të lëshuara nga Drejtoria Komunale e Arsimit dhe Shkencës, pasi të njëjtat janë nxjerr nga një organ që është i pajisur me autorizime publike, çka për gjykatën kjo provë ka fuqi të saktësisë për

atë që konfirmon, bazuar në nenin 329 paragrafit 1 të Ligjit të procedurës kontestimore.

Ndërsa gjykata vendosi si në pikën e tret të dispozitivit të këtij aktgjykimi, ku vendosi që pjesa e kërkesëpadisë për të gjithë paditësit prej datës 18.04.2017 deri me datë 28.03.2019 , te refuzohet si e parashkruar për faktin se sipas Ligjit të Punës, nenit 87 theksohet se, citojmë: *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*.

Ndërkaq në rastin konkret shihet se padia e paditësit është parashtruar pranë kësaj gjykate me datë 28.03.2022, qka do të thotë se kur kthehemi tri vite mbrapa, i bie data 28.03.2019, pra periodha para kësaj të fundit përfshin kohën e parashkrimit.

Për kamatëvonesë gjykata vendosi konform nenit 382 par. 2 i LMD-së.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale, gjykata e mbështeti në nenin 452.1 të LPK-së duke ia njohur paditësit shpenzimet e procedurës si në vijim: për përpilimin e padisë vlerën shumë prej **104 euro**, dhe shumë prej **21 euro** në emër të taksës gjyqësore ,dhe shpenzimet e procedurës që krijohen.

Gjykata aktgjykimin e ka marr në kuptim të nenit 152 të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-DEGA NË SUHAREKË,
C.nr.192/22 dt.14.05.2024**

Gjyqtari
Robert Tunaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 ditëve pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.

Numri i lëndës: 2022:057897
Datë: 14.05.2024
Numri i dokumentit: 05682538